



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:176471
Datë: 29.12.2022
Numri i dokumentit: 03808702
C.nr.1022/2021

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN -Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Blerim Beshtica, me bashkëpunëtoren profesionale V. A., në çështjen juridike kontestimore të paditëseve B. H. dhe J. Ç., që të dyja nga Gj., të përfaqësuar me autorizim nga N. D., avokat nga P., Rr. "M. F.", objekti K. G. Hyrja F, nr.4, kundër të paditurës B. K. e S. me seli në P., me objekt kontesti kompensim i dëmit material dhe jo material, jashtë seance, më datë 29.12.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

Konsiderohet e tërhequr padia e paditësve B. H. dhe J. Ç. që të dyja nga Gj., e paraqitur ndaj të paditurës B. K. e S. me seli në P., me objekt kontesti kompensim dëmi material dhe jo material.

A r s y e t i m

Paditëset, përmes të autorizuarit të tyre, kanë parashtruar padi në këtë gjykatë më datë 06.08.2021 kundër të paditurës, lidhur me çështjen kontestimore kompensim dëmi material dhe jo material.

Gjykata me aktvendimin C.nr.1022/2021 e datës 01.11.2022 i ka ftuar paditëset përmes të autorizuarit të tyre që në afat prej 15 dite ta përcaktojnë vlerën e objektit të kontestit në petitumin e padisë, dhe pas precizimit të vlerës të paguajnë diferencën e taksës gjyqësore për vlerën e precizuar sipas precizimit të kërkesëpadisë, duke e njoftuar të njejtin edhe për pasojat ligjore në rast të mos veprimit sipas aktvendimit të kësaj gjykate, e më decidivisht si në këtë aktvenim.

Paditëset, përkatësisht i autorizuari i tyre edhe përkundër faktit se aktvendim e sipërcekur e ka pranuar më datë 29.11.2022 (ku shihet nga fletëkthesa për dorëzim personal) i njëjti nuk ka vepruar, respektivisht nuk e ka plotësuar padinë, andaj gjykata bazuar në nenin 253.5 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), *padinë e paditëseve e ka konsideruar të tërhequr.*

Nga të cekurat, dhe në bazë të nenit 142 dhe 253.5 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
C.nr.1022/2021, me datë 29.12.2022

Gjyqtari,
Blerim BESHTICA

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.